



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

**Rregullore**

**Për ngritjen dhe funksionimin e redaksive të periodikëve  
shkencorë të Akademisë së Shkencave**

**Neni 1  
Objekti**

Objekt i kësaj rregullorje janë:

1. Parimet bazë të politikës editoriale që zbatohen nga redaksitë e periodikëve që boton Akademia e Shkencave;
2. Mënyra e ngritjes dhe e funksionimit të redaksive të tyre;
3. Kriteret themelore të pranimit, vlerësimit, recensimit, redaktimit dhe botimit të artikujve shkencorë në to.

**Neni 2  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullorje është:

1. Të përcaktojë standarde të njësuara shkencore dhe teknike sipas kërkesave të njohura ndërkombëtarisht, që garantojnë origjinalitet, cilësi dhe ndikim në fushat kërkimore që kanë për objekt periodikët shkencorë të Akademisë së Shkencave;
2. Të vendosë dhe shpallë rregullat e standardizimit teknik që zbatohen në marrëdhëniet midis redaksive të periodikëve dhe autorëve që kanë interes të botojnë artikuj shkencorë, recensione dhe informacione në to;

3. Të caktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e redaksive si ushtruese të funksionit të Akademisë së Shkencave si ent botues; si dhe detyrimet ndaj organizmave dhe subjekteve shkencore ndërkombëtare që certifikojnë botimet periodike shkencore.

### Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

1. Ligjin nr. 53/1019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*, neni 4 pika 8, neni 5 germa dh dhe neni 12 germa c;
2. Në *Statutin e Akademisë*, neni 4 pika 8, neni 31 pika 3 dhe neni 48;
3. Në *Rregulloren e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave*, nenet 2, 5, 6, 7 dhe 21;
4. Për aspekte të veçanta kjo rregullore mbështetet edhe në Ligjin nr. 35/2026 *Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to*.

### Neni 4 Parime të etikës së botimit

1. Parimet themelore të etikës së botimit dhe qendrimet bazë të redaksive të periodikëve ndaj plagjiaturës dhe manipulimit përcaktohen dhe i përmbahen *Kodit europian të etikës në kërkimin shkencor*, që është pjesë e Statutit të Akademisë së Shkencave.
2. Revistat që botohen nga Akademia e Shkencave mbështeten në parimin e konkurrencës për cilësi dhe origjinalitet. Në procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes së lëndës për botim redaksitë mbështeten në parimin e objektivitetit. Motivet jashtëshkencore për botim janë të përjashtuara.

### Neni 5 Periodikët e Akademisë së Shkencave

1. Akademia e Shkencave boton periodikët shkencorë *Studia Albanica* dhe *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences* (më tej: A-JNTS) që janë tribuna të mendimit shkencor të dy seksioneve gjegjëse dhe të bashkëpunëtorëve të tyre në komisione të përhershme, në njësitë e kërkimit dhe në rrjetin akademik-universitar brenda dhe jashtë vendit.

2. Akademia e Shkencave, me cilësinë e entit botues, mund të themelojë tribuna të tjera shkencore, në përputhje me interesa shkencorë afatgjatë.
3. Botimet e brendshme jubilarë e përkujtimore dhe përmbledhësit e punimeve që paraqiten në to nuk konsiderohen periodikë.

#### Neni 6

#### Politika editoriale

1. Periodikët që boton Akademia e Shkencave kanë karakter përzgjedhës.
2. Politika editoriale e redaksisë së revistës *Studia Albanica* ka si qëllim kryesor paraqitjen dhe promovimin e arritjeve më cilësore të dijes shqiptare kryesisht në mjedisin jashtë vendit gjatë periudhës rrjedhëse.
3. Politika editoriale e redaksisë së revistës *A-JNTS* synon që kërkimi shkencor në Shqipëri të jetë vijimësisht në komunikim me dijen bashkëkohore në Europë e në Botë dhe denjësisht e përfaqësuar në rrjetëzimet shkencore ndërkombëtare.

#### Neni 7

#### *Studia Albanica*

1. *Studia Albanica* është tribunë e pronë shkencore e Akademisë së Shkencave.
2. *Studia Albanica* është revistë e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA). Ajo ka për qëllim të bëjë të njohur vijimësisht kontributet më cilësore shkencore rrjedhëse të kryera më së pari prej studiuesve shqiptarë, si dhe të albanologëve të huaj, në dijet që janë objekt i këtij seksioni (arkeologji dhe histori; gjuhësi dhe antropologji kulturore; trashëgimi shpirtërore dhe materiale; etnomuzikologji dhe folklor; studime për letërsinë, artin dhe identitetin etj.).

#### Neni 8

#### *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences*

1. *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences (A-JNTS)* është tribunë dhe pronë shkencore e Akademisë së Shkencave.
2. *A-JNTS* është revistë e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike (SSHNT). *A-JNTS* ka për qëllim të bëjë të njohura arritjet më cilësore shkencore të studiuesve të fushave që janë objekt i SSHNT në bashkësinë

gjegjëse brenda dhe jashtë vendit; të mbajë dhe rikonfirmojë në vijimësi lidhjet mes studiuesve shqiptarë e të huaj të këtyre fushave.

#### Neni 9 Gjuha e botimit

1. *Studia Albanica* dhe *A-JNTS* si rregull botohen në gjuhën angleze.
2. Kur lënda e revistës formohet specifikisht nga kontribute të paraqitura prej studiuesve të huaj pjesëmarrës në simpoziume, kuvende a konferenca shkencore të organizuara nga Akademia e Shkencave, aktet e tyre mund të botohen si artikuj edhe në gjuhët e pranuar për referim paraprakisht.

#### Neni 10 Rubrikat e përhershme

1. Rubrikat e përhershme në *Studia Albanica* dhe *A-JNTS* respektojnë raportet dhe renditjen sipas standardeve të *International Center of ISSN* dhe janë: 1. Artikujt shkencorë; 2. Recensionet; 3. Informacioni shkencor.
2. Raportet mes tri rubrikave të përhershme në tërësinë e lëndës së numrit janë si vijon: a). *Artikuj shkencorë* - jo më pak se dy të tretat e vëllimit; b). *Recensione, kritikë e bibliografi* rreth botimeve më të rëndësishme akademike-universitare gjatë periudhës rrjedhëse sipas fushave brenda dhe jashtë vendit - deri në një të pestën e vëllimit; c). Pjesë plotësuese e periodikut është *rubrika e kronikës dhe informacionit për jetën shkencore akademike dhe universitare gjatë periudhës rrjedhëse* (kongrese, simpoziume, kuvende, konferenca, ngjarje jubilarë, kushtime *in memoriam* dhe *ad honorem*, nekrologji).
3. Në raste të veçanta mund të shtohet rubrika *Materiale e dokumente*, që, për efekt raportesh të përgjithshme, konsiderohet *informacion shkencor*.

#### Neni 11 Artikulli shkencor

1. Artikulli shkencor që dorëzohet për botim në revistat periodike të Akademisë së Shkencave përmban edhe: a). *Abstraktin* (anglisht dhe shqip); b). *Fjalët-çelësa*; c). *Bibliografinë*.
2. Njësimi teknik i madhësisë së secilit përbërës; i rendit të brendshëm dhe raporteve mes tyre, bëhet nga redaksia.

Neni 12  
Periodiciteti

1. *Studia Albanica* dhe *A-JNTS* dalin rregullisht dy herë në vit. Për numrat jashtë këtij periodiciteti vendosin redaksitë.
2. Numrat jashtë rregullsisë periodike quhen *numra specialë* dhe llogariten *shtesë (supplement)* në numërimin progresiv të periodikëve.
3. Vonimi i numrit më shumë se një vit pas periudhës rrjedhëse konsiderohet prishje e periodicitetit dhe cenim i statusit të periodikut.

Neni 13  
Burimet e lëndës shkencore

1. Përgatitja e numrit vijues të periodikut nis një vit më përpara, me botimin e *thirrjes për kontribut*, në shqip e anglisht, e cila konceptohet nga vetë redaksia dhe shpallet prej saj. Përmbajtja e numrit propozohet mbi bazën e prurjeve shkencore të depozituara në redaksi nga autorët e interesuar në përgjigje të *thirrjes për kontribut*.
2. Redaksia e revistës *Studia Albanica* mund të përzgjedhë për përkthim e botim ndër artikujt shkencorë të publikuar së fundmi në shqip në periodikë shkencorë ose pjesë të studimeve monografike vetjake, për shkak të rëndësisë së tyre për studiuesit e huaj. Përkthimi e botimi i tyre anglisht bëhet me pëlqimin e autorëve dhe të redaksive të botimit shqip. Nuk mund të përgjidhen artikuj ose kontribute të tjera shkencore që janë botuar a janë në proces botimi në një gjuhë tjetër të huaj.
3. Për revistën *Studia Albanica* kanë përparësi kontributet për çështje të ndjeshme në albanologji gjatë periudhës rrjedhëse. Redaksia nxit debatin shkencor dhe fton për kontribute ekskluzive edhe albanologë nga radhët e studiuesve të huaj.

Neni 14  
Kryeredaktori

1. Kryetari i SSHSHA dhe kryetari i SSHNT janë gjegjësisht kryeredaktorë të periodikëve që botohen prej tyre.
2. Kryeredaktori thërret dhe drejton mbledhjet e redaksisë dhe përgjigjet për politikën editoriale.

Neni 15  
Redaksitë

1. Përbërja e redaksisë së revistës *Studia Albanica* dhe e revistës *A-JNTS* propozohet nga kryeredaktori gjegjës dhe miratohet nga Kryesia e Akademisë së Shkencave. Ndryshime të pjesshme në redaksi për shkak vakancës objektive bëhen nga Kryetari, me propozim të kryeredaktorit.
2. Numri i anëtarëve të redaksisë është 9 veta. Redaksia ka *anëtarë të brendshëm* dhe *anëtarë të jashtëm*. *Anëtarët joakademikë janë anëtarë të jashtëm* dhe përbëjnë shumicën e redaksisë. Anëtarët me qendrim të përhershëm brenda vendit përbëjnë jo më pak se dy të tretat e redaksisë. *Anëtarët e jashtëm* zgjidhen nga radhët e studiuesve me gradën *doktor i shkencave* dhe me tituj shkencorë. Në përzgjedhjen e anëtarëve të jashtëm të redaksisë merret mendim edhe nga drejtuesit e institucioneve të arsimit të lartë, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara.
3. Përgjegjësia për cilësinë shkencore të periodikut është e redaksisë.

Neni 16  
Bordi i nderit

1. Bordi i nderit ka *karakter ndërkombëtar* dhe ngrihet sipas standardeve të *International Center of ISSN*. Anëtarësia e bordit të nderit propozohet nga redaksia dhe miratohet nga Kryesia. Anëtarët e bordit zgjidhen gjegjësisht nga radhët e albanologëve më të vlerësuar dhe nga radhët e studiuesve të huaj me të cilët Akademia e Shkencave ka bashkëpunim të qendrueshëm, si dhe prej organizatave ndërkombëtare si IAC, IAP, SAPEA etj.
2. Bordi i nderit paraqitet më vete, në vend të dukshëm në frontespicin e periodikut. Anëtarëve të bordit të nderit u merret paraprakisht pëlqimi për t'u paraqitur me këtë cilësi në pasaportën e periodikut përkatës dhe janë *garantë intelektualë* të cilësisë shkencore të periodikëve.
3. Anëtarët e bordeve të nderit mund të ftohen për të këshilluar dhe vlerësuar lëndën, veçmas *në rastet kur është e nevojshme që ekspertiza të eksteriorizohet*; për të nxitur pjesëmarrjen e studiuesve të huaj si autorë kontribuues në periodikët e Akademisë së Shkencave; për të vendosur dhe stabilizuar lidhje të qendrueshme me agjenci të huaja të certifikuara për vlerësim të jashtëm apo oponencë të specializuara të artikujve shkencorë.

4. Anëtarët vendës të bordit të nderit nuk mund të jenë më shumë se një e treta e numrit të përgjithshëm të tij.

#### Neni 17

##### Redaktori shkencor i periodikëve

1. Redaktori shkencor i periodikëve kryen detyrat sipas përshkrimit në rregulloren *Për funksionimin e administratës në Akademinë e Shkencave*.

2. Redaktori shkencor mban lidhjet midis redaksisë, autorëve dhe recensuesve; pranon dhe koleksionon lëndën e numrit të ri në një dosje të veçantë; i paraqet periodikisht kryeredaktorit gjendjen e lëndës që disponohet për numrin e ri; njofton anëtarët e redaksisë me një relacion paraprak për prurjet; bën sugjerime për shtesat e nevojshme të lëndës së numrit; propozon përmbajtjen e tij, bën kodifikimin e artikujve sipas kritereve të *Universal Decimal Classification (UDC) - katalogimit dhjetor universal (KDU)*, si dhe redakton lëndën e numrit në gjuhën e botimit.

#### Neni 18

##### Mbledhja e redaksisë

1. Mbledhja e redaksisë thirret dhe drejtohet nga kryeredaktori. Mbledhja e saj mund të kërkohet edhe nga tre anëtarë. Redaksia mbledhet jo më pak se dy herë për çdo numër.

2. Mbledhja e redaksisë zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të saj.

3. Vendimet merren me shumicën e votave të të pranishmëve, pas njohjes me relacionet e anëtarëve të redaksisë e recensionet dhe pas diskutimit shkencor. Vendimet merren me jo më pak se një të tretën e votave të anëtarëve. Votimi bëhet i hapur.

#### Neni 19

##### Shqyrtimi e miratimi i lëndës

1. Rendi i ditës dhe data e mbledhjes së redaksisë njoftohen nga kryeredaktori ose redaktori shkencor jo më pak se një javë përpara.

2. Lënda e disponuar u shpërndahet paraprakisht anëtarëve të redaksisë sipas fushave të ekspertizës nga kryeredaktori ose redaktori shkencor.

3. Anëtarët e redaksisë relatojnë në mbledhjen e redaksisë nëse artikulli është i pranueshëm dhe rekomandojnë recensuesit. Në rastin kur mendimi i anëtarit të redaksisë është për refuzimin e artikullit, argumentimi paraqitet me shkrim.
4. Numri i recensuesve është së paku dy për çdo artikull.
5. Nëse raportet midis disiplinave ose një interes shkencor i rëndësishëm e kërkon, si dhe në rastet kur lënda e disponueshme është e paplotë, redaksia vendos për garantimin e artikujve shtesë.
6. Mbledhja e dytë e rregullt e redaksisë bëhet pas njohjes me vlerësimin e recensuesve, që u qarkullohen paraprakisht anëtarëve nga redaktori shkencor i revistës. Në mbledhjen e dytë merret vendim për tryezën e lëndës, ndarjen e saj në rubrika, renditjen dhe ndryshimet e mundshme në frontespice.
7. Anëtarët e jashtëm të redaksisë gëzojnë të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm për çdo mbledhje, në masën që caktohet nga Kryesia, me propozim të grupit të vlerësuesve që funksionon pranë këshillit të botimeve.

#### Neni 20

#### Recensuesi dhe recensionimi

1. Recensuesit e artikujve që botohen në *Studia Albanica* dhe në *A-JNTS* zgjidhen nga redaksitë përkatëse, në përputhje me parimin e kompetencës shkencore në fushën e ekspertizës.
2. Redaksitë konceptojnë dhe miratojnë formularin standard të recensionimit, që përfshin pyetjet themelore për vlerën e kontributit, interesin shkencor, origjinalitetin, përputhshmërinë me prioritetet e periodikut, përjashtimin e konfliktit të interesit e mangësitë e mundshme.
3. Recensuesit caktohen në mbledhjen e redaksisë dhe zgjidhen nga specialistët e fushës përkatëse të ekspertizës. Kur është e mundshme, njëri nga recensuesit është nga radhët e anëtarëve të Asamblesë.
4. Marrëdhëniet e redaksisë me autorët dhe recensuesit ndërtohen sipas parimeve dhe procedurave ndërkombëtare të standardit të vlerësimit *peer review (refereeing)* dhe *peer learning*, në përputhje me kërkesat e dokumentit e përbashkët *The Open Method of Coordination in Research Policy*, miratuar nga Bashkimi Europian më 1999.
5. Redaksia ruan fshehtësinë e autorësisë për recensuesit (vlerësuesit e jashtëm) dhe anasjelltas: fshehtësinë nominale të recensuesit për autorin.



6. Redaksia mund të krijojë një rrjet të përhershëm vlerësuesish të jashtëm (recensuesish). Kur mbi bazën e recensionimit të parë nuk është e mundshme të merret vendim, redaksia kërkon recensione shtesë.

#### Neni 21

##### Standarde teknike të njësuara

1. Formatimi teknik i tekstit që botohet në periodikët e Akademisë së Shkencave (lloji i shkronjës, madhësia, bardhësitë, ndërlinjat) është çështje që vendoset nga redaksia.
2. Redaksia zgjedh dhe shpall publikisht në faqen zyrtare të institucionit një nga sistemet e njohur ndërkombëtarisht të citimeve dhe bibliografisë me së paku gjashtë muaj para miratimit të lëndës së numrit vijues.

#### Neni 22

##### Indeksi

1. Periodikët shkencorë të Akademisë së Shkencave botohen me ISSN dhe janë revista të indeksuara sipas standardit ndërkombëtar që konfirmohet nga *International Center of ISSN*.
2. Redaksia merr në konsideratë kërkesat formale të *International Center of ISSN* edhe për paraqitjen teknike të revistës.

#### Neni 23

##### Aksesi

1. Periodikët shkencorë të Akademisë së Shkencave publikohen *online* në faqen zyrtare të saj jo më vonë se gjashtë muaj pas botimit të shtypur. Ato janë pjesë e programit *për rrjetëzimin e periodikëve në gjuhën shqipe dhe për një platformë të përbashkët për qasje të lirë në to*.
2. Periodikët u përgjigjen kërkesave të njohura ndërkombëtarisht të pranuar nga *Open Access* dhe kanë si qëllim imediat të regjistrohen në njërën nga listat që e garantojnë këtë status: *Scopus database* a *Tempus List*.
3. Botimi i periodikëve synon dhe realizon të njëjtat kërkesa dhe procedura që bëjnë të mundur verifikimin e cilësisë dhe origjinalitetit të tyre përmes treguesit ndërkombëtar IF (*Impact Factor*).

**Neni 24**  
**E drejta e autorit**

1. Autori ka të drejtën e një honorari që llogaritet sipas tarifave në fuqi.
2. Për shkak të specifikave terminologjike dhe të rëndësisë që ka cilësia e përkthimit për komunikimin me rrjetin e studiuesve jashtë vendit, artikujt që botohen në revistën *Studia Albanica* pranohen edhe në gjuhën shqipe. Përkthimi në gjuhën angleze bëhet nga enti botues, me ekspertë të certifikuar, njohës të kësaj gjuhe në nivelin C1.
3. Kur artikulli përkthehet nga enti botues, autori gëzon të drejtën e një shpërblimi të pjesshëm.
4. Anëtarët e redaksisë dhe autori i artikullit gëzojnë të drejtën e një kopjeje të numrit. Autorit të artikullit i jepen edhe pesë separate. Recensuesit i jepet separati i artikullit që ka vlerësuar.

**Neni 25**  
**Dispozita kalimtare**

1. Me miratimin e kësaj rregullorje kryetarët e seksioneve propozojnë brenda dy muajsh përbërjen e re të redaksive dhe të bordeve të nderit, sipas përcaktimeve të saj. Kryesia miraton përbërjen e re të redaksive.
2. Rregulla të mëparshme për mënyrën e ngritjes dhe funksionimit të redaksive të periodikëve dhe për politikën editoriale të tyre, në rastin kur nuk pajtohen me këtë rregullore, shfuqizohen.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave shqip e anglisht.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR